



**FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS  
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION**

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë  
Tel: +383-44-170-586 / Email: [info@fppk.com](mailto:info@fppk.com) / ueb: [www.fppk.com](http://www.fppk.com)

**REGULLORE PËR ORGANIZIMIN E  
GARAVE VENDORE DHE  
NDËRKOMBTARE TË PINGPONGUT**

PRISHTINË 2024

Në përputhje me nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës, Federata e Pingpongut e Kosovës, në mbledhjen e datës: 14/12/2024 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E GARAVE TË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS**

### **Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore vërtetohet mënyra e dhënies së të drejtave dhe obligimeve organizatorit të garave, mënyra e caktimit dhe të drejtat e obligimet e personave zyrtarë në gara, kushtet për ndeshje, pajisja, veshmbathja, shorti, koha, rrjedha e garave, sjellja e sportistëve, shpërblimet dhe rregulla tjera të rëndësishme për zhvillimin e garave.

#### **Neni 2.**

Rregullat e kësaj Rregulloreje do të zbatohen në të gjitha garat zyrtare në Kosovë.

#### **Neni 3.**

Në garat ndërkombëtare që zhvillohen në Kosovë, do të zbatohen rregullat për gara ndërkombëtare (Handbook, Kreu 3) dhe rregullat e kësaj Rregulloreje që kanë të bëjnë me dhënien e të drejtës së organizimit të garave.

### **I. Dhënia e të drejtës së garave**

#### **Neni 4.**

Të drejtat për organizimin e garave të bazuara në konkurs dhe në propozim të Komisionit të garave e jep Bordi ekzekutiv i Federatës që është kompetent për organizimin e garave.

Konkursi i shpallur, së bashku me propozimin e Kalendarit të garave, u dorëzohet klubeve, së paku 30 ditë para mbledhjes së Bordi ekzekutiv, i cili vendos për dhënien e të drejtës së garave.

Për të fituar të drejtën e organizimit mund të kandidohen të gjitha klubet e regjionit ku organizohen garat.

Organizatorët e garave ekipore sipas sistemit të Ligës, me kusht që të plotësojnë kushtet e kësaj Rregulloreje, do të caktohen me short, të cilin do ta bëjë Bordi përkatës i Ligës.

#### **Neni 5.**

Kandidaturën për organizimin e garave klubet e paraqesin me shkrim. Kandidatura e paraqitur, duhet që përveç tjerash t'i plotësojë të gjitha kushtet nga kjo Rregullore.

#### **Neni 6.**

Bordi i Federatës, i cili ka kompetenca për organizimin e garave, do t'ia besojë organizimin e garave klubit, i cili do të garantojë plotësimin e kushteve nga kjo Rregullore, duke marrë parasysh:

- Barazinë e ndarjes së organizimit;
- Përfaqësimin cilësor dhe sasior të klubeve të pingpongut dhe të sportistëve në regjionin e caktuar;
- Mundësinë e vendosjes dhe akomodimit dhe lidhjet komunikative;
- Infrastrukturën përkatëse për pingpong (gjqtarët, punëtorët e pingpongut etj).

#### **Neni 7.**

Me kalendarin e garave për stinorin përkatës do të njoftohen të gjithë organizatorët e garave në atë stinor, kështu që kalendarin e garave ka vlerë të informatorit zyrtar për dhënien e organizimit të garës.

#### **Neni 8.**

Gara e fituar njëherë nuk mund të shfuqizohet.

Nëse për arsye të pranuara ndonjë organizator i caktuar nuk mund ta organizojë ndonjë garë, është i obliguar që për këtë menjëherë ta njoftojë Komisionin e garave.

Mospërbajtja e kushteve të nenit të mëparshëm tërheq me vete përgjegjësi disiplinore.

## **II. Të drejtat dhe obligimet e organizatorit**

### **Neni 9.**

Organizatori ka të drejtë të vjelë të hollat e tubuara nga paraqitja e ekipeve apo e sportistëve. Lartësinë e shumës për pjesëmarrje e cakton organizatori me kusht që ajo të mos jetë më e madhe se shuma, të cilën për çdo stinor e cakton Bordi i FPPK-së.

Pagesa për paraqitje bëhet para fillimit të garës.

Ekipi apo sportisti i paraqitur është i obliguar të paguajë për paraqitje, pa marrë parasysh a merr pjesë në garë apo jo.

### **Neni 10.**

Organizatori i garave është i obliguar:

- Që së paku 30 ditë para fillimit të garës t'ia vë në dispozicion Komisionit të garave të gjitha elementet e nevojshme për hartimin e propozicioneve, në mënyrë që ai të mund t'ua japë të gjitha klubeve të interesuara;
- Të sigurojë pajisjet (tavolinat, rrjetat, topat, numratorët etj.) në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
- Të sigurojë shërbimet e gjyqtarëve;
- Të sigurojë personelin e mjaftueshëm për udhëheqjen e garave;
- Të sigurojë mundësinë e dhënies së ndihmës së parë mjekësore;
- Të sigurojë mundësinë e vendosjes së pjesëmarrësve dhe të personave zyrtarë të garës;
- Të caktojë përfaqësuesin e vet në udhëheqësinë e garave;
- Të sigurojë trofetë sportivë për ekipet dhe sportistët më të mirë;
- T'a lajmërojë garën (tubimin publik) në stacionin kompetent të policisë;
- T'i përmbahet dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe akteve tjera të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me garat.
- Në garat ekipore sipas sistemit të Ligës, Bordi kompetent i ligës do të konsiderohet si organizator dhe e merr përgjegjësinë për plotësimin e kushteve që dalin nga ky nen.

### **Neni 11.**

Federata, që është kompetente për dhënien e të drejtës së garës, mund ta obligojë organizatorin që t'ia vëjë në dispozicion hapësirën e caktuar për nevoja të Federatës pa pagesë. Në rastin kur Federata dëshiron t'a shfrytëzojë hapësirën për garë është e obliguar që këtë ta shënojë, kur e jep të drejtën e organizimit të garës. Vëllimi i hapësirës së dhënë për shfrytëzim bëhet me marrëveshje të caktuar dhe nuk mund të jetë më shumë se 20 % e çfarëdo forme të hapësirave zyrtare.

## **III. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E SPORTISTËVE**

### **Neni 12.**

Paraqitjet për pjesëmarrje në gara bëhen me shkrim ose me postë elektronike, drejtuar Komisionit të garave.

Paraqitjen e ekipit për gara ekipore dhe të sportistit për gara individuale e bën klubi, kurse i nënshkruan personi i autorizuar për kontakt me Federatën.

### **Neni 13.**

Ekipi ose sportisti do të pranohet për gara nëse i plotësojnë kushtet nga dispozitat për atë garë.

### **Neni 14.**

Me paraqitjen për gara ekipet dhe sportistët i pranojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat dalin nga kjo Rregullore dhe propozicionet për gara.

### **Neni 15.**

Me rastin e ardhjes në garë, para fillimit zyrtar të saj, sportisti është i obliguar t'a tregojë licencën për gara.

Nëse sportisti nuk mund ta tregojë licencën për gara, delegati mund t'i lejojë të marrë pjesë në gara me kusht që të japë deklaratë me shkrim se është i regjistruar, i kontrolluar nga mjeku dhe i aftë për

ndeshje. Nëse delegati në atë rast e lejon sportistin që të marrë pjesë në garë, sportistit i cili nuk ka mundur ta tregojë licencën për gara dhe e ka dhënë deklaratën e lartpërmendur, ai garues është i obliguar, që brenda 24 orëve pas mbarimit të garës, t'i dërgojë Komisionit të garave kopjen e licencës së vet, e cila do të dëshmojë vërtetësinë e deklaratës së tij të dhënë me shkrim (regjistrimi dhe kontrollimi shëndetësor duhet të jenë të rregullt).

Në rast se sportisti nuk e dërgon kopjen e licencës së garave brenda afatit të caktuar ose nëse vërtetohet se deklarata e dhënë është e pavërtetë, sportisti do të ndëshkohet me dënim mandator dhe kundër tij do të propozohet fillimi i procedurës disiplinore kundër atij sportisti.

#### **Neni 16.**

Ekipi apo sportisti i paraqitur për gara janë të obliguar të marrin pjesë në garën për të cilën janë paraqitur.

Kur ekipi apo sportisti paraqiten në gara ata janë të obliguar të marrin pjesë në të derisa të jenë në konkurrencë, duke përfshirë edhe ndarjen e shpërblimeve.

#### **Neni 17.**

Për shkeljen e nenit 16 të kësaj Rregulloreje:

- Nëse mosardhjen në garë e arsyetojnë me arsye, të cilën Komisioni i garave ta vlerësojë si të arsyeshme;
- Nëse largohen nga garat me arsye të cilën udhëheqësia e garave e vlerëson si të pranueshme.

#### **Neni 18.**

Gjatë kohës sa zgjatë gara, sportisti është i obliguar t'i përmbahet orarit të garave, të paraqitet me veshje sportive, që t'i pranojë vendimet e personave zyrtarë dhe të ketë sjellje dinjitoze.

### **IV. Llojet e garave**

#### **Neni 19.**

Garat zyrtare në kuptimin e dispozitave të Rregullores për sistemin e garave janë:

- Garat për titull (ekipore dhe individuale);
- Gara për demonstrimin dhe kontrollimin e cilësisë (Top-turnetë e Kosovës dhe turnetë e ftuara);
- Garat e hapura, me rastin e ndonjë ngjarjeje.

Të gjitha garat nga ky nen janë publike.

#### **Neni 20.**

Në të gjitha garat zyrtare do të zbatohen rregullat e pinpongut (Handbook, kreu i dytë) dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

### **V. Përgatitja e garave**

#### **a) Propozicionet**

#### **Neni 21.**

Për çdo garë duhet të hartohen propozicionet dhe t'u dorëzohen të gjithë pjesëmarrësve të mundshëm, së paku 7 ditë para fillimit të garës.

Propozicionet i harton Komisioni i Federatës, e cila është kompetente për organizimin e garës.

#### **Neni 22.**

Propozicionet për gara patjetër duhet të përmbajnë:

- Emrin e organizatorit,
- Vendin dhe kohën e mbajtjes së garës me adresë të saktë të sallës ku do të mbahet dhe me kohën e saktë të fillimit të garës,
- Kush ka të drejtë të marrë pjesë në gara,
- Cilat disiplina do të mbahen në garë,
- Informata për pajisjet që do të përdoren në garë,
- Afati për paraqitje dhe kujt i drejtohet,
- Vendi dhe koha e hedhjes së shortit,

- Emri i Gjyqtarit suprem në garë,
- Informimi rreth vendosjes së mundshme të sportistëve,
- Kohën e pritjes, në rast se ekipi ose sportisti vonohet.
- Preferohet që propozicionet të përmbajnë edhe të dhënat rreth çmimit të shërbimeve të pansionit, lidhjet e trafikut, llojet e shpërblimeve dhe të dhëna të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me garën.

## b) Shorti për garë

### Neni 23.

Për të gjitha garat, pozitat nistore të ekipeve apo të sportistëve caktohen me short në mënyrën e përshtuar në Rregulloren për sistemin e garave.

Shorti për të gjitha garat është i hapur.

Në hedhjen e shortit mund të jenë të pranishëm të gjithë sportistët e paraqitur, përkatësisht përfaqësuesit e ekipeve të paraqitura dhe përfaqësuesit e mediave.

Për të gjitha garat zyrtare shorti bëhet në selinë e Federatës kompetente për dhënien e të drejtës për garë.

## c) Orari i garës

### Neni 24.

Me rastin e përpilimit të orarit të garës është e domosdoshme t'i përmbahemi këtyre normave për numrin maksimal të ndeshjeve që mund t'i kenë ekipi apo sportisti brenda një dite.

a) Takime ekipore	deri në fitoren e katërt të një ekipi	deri në fitoren e tretë të një ekipi
Ora 9-14 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
16-21 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
9-21 (12 orë)	6 ndeshje	8 ndeshje
b) Ndeshje individuale	në 4 seta të fituar	në 3 seta të fituar
9-14 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
16-21 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
9-21 (12 orë)	6 ndeshje	8 ndeshje

Kur flitet për turnetë njëditorë (në kohëzgjatje më shumë se 7 orë), sportistëve duhet t'u sigurohet pushim prej së paku 2 orëve ndërmjet ndeshjeve.

### Neni 25.

Individët apo ekipet, nuk janë të obliguar të luajnë numër më të madh ndeshjesh se që e parasheh neni 24.

Përgjithësisht, në rast të ndonjë mbiforce për shkak të së cilës gara nuk do të mund të kryhej në afatin e caktuar kohor, udhëheqësia e garës mund të caktojë numër më të madh të ndeshjeve, kurse ekipet ose sportistët nuk mund të refuzojnë të luajnë.

### Neni 26.

Në garat ku janë të përfshira garat ekipore dhe individuale, garat ekipore planifikohen ashtu që të përfundojnë para fillimit të atyre individuale.

Përgjithësisht, me lejen e organizatorit të garave, garat individuale mund të fillojnë edhe më herët.

## **VI. Kushtet për ndeshje, pajisjet dhe veshmbathja e sportistëve**

***Vërejtje:** Nenet 27-33 nuk do të aplikohen menjëherë për shkak të kushteve të vështira për momentin. Këto nene do të shqyrtohen nga Kuvendi në baza vjetore dhe Kuvendi do të marrë vendim të veçantë për hyqjen në fuqi të tyre. Mbetet obligim i Organizatorëve që deri atëherë të sigurojnë kushte sa më të përafërta me këto nene.*

### **a) Hapësira për ndeshje**

#### **Neni 27.**

Objekti në të cilin mbahet gara duhet të jetë i mbyllur anash, me mundësinë e ajrosjes e rregulluar ashtu që të mos ndikojë në ndeshje.

Në objekt duhet të jenë zveshtoret për sportistë dhe toaletet.

Për mbajtjen e garave të nivelit III, para objektit ose në sallë duhet të jetë, në vend të dukshëm, i varur flamuri i Kosovës.

#### **Neni 28.**

Hapësira për ndeshje duhet të jetë së paku 10x5 m, kurse për garat për të rritur të nivelit III 12x6 m.

Në garat e nivelit III, hapësira për ndeshje duhet të jetë e rrethuar me rrethojë, ngjyrë të mbyllur, të lartë afro 75 cm.

Brenda hapësirës për ndeshje, përveç tavolinës gjendet edhe tavolina e gjyqtarit e vendosur anash tavolinës në lartësi të rrjetës dhe e larguar nga sipërfaqja për ndeshje së paku 1 m.

#### **Neni 29.**

Brenda hapësirës për ndeshje mund të ekspozohen porosi propagandistike vetëm në pajisje dhe në rekuizitë që përdoren atje.

Porositë propagandistike apo shenjat në rrethojat e arenës mund të punohen më së shumti në dy ngjyra, por që nuk mund të jenë më të larta se 40 cm.

Porositë propagandistike në tavolinat e gjyqtarëve mund të jenë të madhësisë deri 750 cm<sup>2</sup> në çdo anë.

Vendosja e porosive propagandistike mund të bëhet edhe nën sipërfaqen për ndeshje, por ashtu që të mos i pengojnë sportistët dhe nuk guxojnë të jenë më të gjata se 60 cm.

Për porosi propagandistike brenda arenës nuk mund të lejohen ngjyra shkëlqyese dhe fluoreshente dhe me ngjyrë sikur edhe ngjyra e topit, me të cilin luhet.

#### **Neni 30.**

Prapavija e hapësirës për ndeshje duhet të ketë ngjyrë të mbyllur të njëtrajtshme, pa burime të dritës së shkëlqyer, pa depërtimin e dritës së ditës përmes dritareve të pambuluara.

Pas hapësirës për ndeshje, të rrethuar, në fushën pamore të sportistit nuk mund të vendosen porosi propagandistike me ngjyrë sikur ajo e topit me të cilën luhet.

#### **Neni 31.**

Fuqia e dritës mbi tërë hapësirën për ndeshje duhet të jetë së paku 600 luksa, kurse në cilëndo pjesë të hapësirës për ndeshje së paku 400 luksa.

Burimi i dritës duhet të jetë i larguar nga dyshemeja së paku 3 m.

#### **Neni 32.**

Dyshemeja në të cilën luhet nuk mund të jetë prej betoni, pllakave të qeramikës ose prej guri.

Dyshemeja nuk guxon të jetë me ngjyrë të ndritshme, as nuk guxon të reflektojë dritë.

#### **Neni 33.**

Palestra, në të cilën luhet, duhet të jetë e ngrohur, kurse temperatura nuk guxon të jetë më e ulët se 15<sup>0</sup> C.

### **b) Përgaditjet për ndeshje**

#### **Neni 34.**

Tavolina duhet të jetë e punuar prej druri.

Të gjitha tavolinat në një garë duhet të jenë të cilësisë dhe të firmës së njëjtë.

Për gara të nivelit III në konkurrencët e të rinjve dhe të të rriturve mund të përdoren vetëm tavolinat e lejuara nga ITTF.

Porositë propagandistike ose shenjat në fund të tavolinës duhet të jenë pak më të ndritshme ose pak më të mbyllëta se ngjyra themelore e tavolinës ose të zeza dhe jo më të mëdha se 400 m<sup>2</sup>.

#### **Neni 35.**

Në gara mund të shfrytëzohen topat që i përgjigjen kërkesave të kreut të dytë të Handbook-ut, të cilat i lejon Bordi i Federatës, i cili është kompetent për organizimin e garës.

#### **Neni 36.**

Raketa me të cilën luhet duhet t'i përgjigjet kërkesave të kreut të dytë të Handbook-ut, pika katër. Mbulesa e reketës (goma), në anën e raketës që përdoret për goditjen e topit, duhet të jetë e tipit dhe firmës që është lejuar nga ITTF-i, ashtu që firma dhe shenja e ITTF-it gjendet në skaj të raketës afër dorëzës dhe duhet të shihen qartë.

Shtresat e raketës mund të përforcohen për anën e raketës vetëm me folie ngjitëse apo me ngjitësa, të cilët nuk përmbajnë përbërës të ndaluar.

Është e ndaluar ngjitja e reketës në palestrën, në të cilën luhet.

### **c) Veshmbathja e sportistëve**

#### **Neni 37.**

Veshmbathja e sportistëve përbëhet nga fanella me mëngë të shkurtëra, brekët ose fustani i shkurtër, çorapët dhe mbathjet sportive. Mjete të tjera për veshje nuk mund të barten gjatë ndeshjes pa lejen e gjyqtarit suprem.

#### **Neni 38.**

Veshmbathja e sportistëve mund të jetë me çfarëdo ngjyre dhe e dizajnuar ashtu që ngjyra themelore, përveç përreth jakës dhe mëngëve, të jetë qartë e ndryshme nga ngjyra e topit me të cilin luhet.

Në pjesët e veshmbathjes së sportistëve mund të jenë:

- Shenja ose logoja e prodhuesit me madhësi deri 24 cm<sup>2</sup>;
- Logoja e ITTF-it nëse fanella është lejuar nga ITTF-i;
- Numrat ose germa në anën e prapme të fanellës për ta shënuar sportistin ose klubin e tij, me madhësi deri 600 cm<sup>2</sup>;
- Porosi propagandistike.

#### **Neni 39.**

Porosi propagandistike në veshmbathjet e sportistëve janë të limituara në:

- Jo më shumë se tri porosi në pjesën e përparme, anash ose në mëngën e fanellës, qartë të ndara njëra nga tjetra, me sipërfaqe të përgjithshme jo më shumë se 160 cm<sup>2</sup>;
- Jo më shumë se dy porosi propagandistike në brekë ose në fustan të shkurtër, qartë të ndara me sipërfaqe të përgjithshme 80 cm<sup>2</sup>;
- Një porosi propagandistike me madhësi deri 200 cm<sup>2</sup> në pjesën e prapme të fanellës;
- Porosia propagandistike në shenjën e sportistit (numër etj.) mund të jetë me madhësi gjithsej 100 cm<sup>2</sup>.

Shenja (numri) për ta dalluar sportistin, të cilën e kërkon organizatori, ka përparësi ndaj porosisë propagandistike në qendër të pjesës së prapme të fanellës.

#### **Neni 40.**

Kurrëfarë shenje apo stolie nuk mund të vendoset në pjesën e përparme apo anësore të fanellës së sportistit dhe kurrëfarë lënde, p.sh. stoli e bartur nga sportisti, nuk guxon të jetë e varur dhe të shkëlqejë në sytë e kundërshtarit.

#### **Neni 41.**

Në garat ekipore dhe në çifte, sportistët e një ekipi duhet të paraqiten, në gara, me fanella të njëjta, por mund të lejohen ndryshime në të mbathura sportive (çorapë dhe këpucë).

Përrjashtim nga ky nen mund të bëhet me lejen e gjyqtarit suprem, nëse garat ekipore zhvillohen me sistem të turneut (Më shumë ndeshje brenda një dite) ose nëse në ndeshjen e çifteve, në një çift paraqiten sportistët e ekipeve të ndryshme.

#### **Neni 42.**

Ekipet apo sportistët kundërshtarë duhet të kenë veshmbathje të ndryshme ashtu që shikuesit të mund t'i dallojnë.

Nëse në garat e ligës të dyja ekipet dëshirojnë të paraqiten me veshmbathje të njëjtë, gjyqtari suprem do të kërkojë nga nikoqiri që t'i ndërrojë veshmbathjet.

Nëse në turne, të dy ekipet, çiftet apo sportistët dëshirojnë të paraqiten me veshmbathje të njëjta, gjyqtari suprem do të caktojë me short cili ekip, çift apo sportist duhet ta ndërrojë veshmbathjen.

#### **Neni 43.**

Për të gjitha çështjet e rregullsisë ose pranimit të veshmbathjes së sportistëve vendos gjyqtari suprem, me përjashtim që ai nuk mund të vendosë kur veshmbathja është e lejuar nga ITTF-i.

## **VII. Personat zyrtarë në garë**

### **a) Udhëheqësia e garës**

#### **Neni 44.**

Udhëheqësinë e garës e përbëjnë:

Delegati i lidhjes për organizimin e garës, gjyqtari suprem dhe përfaqësuesi i organizatorit.

Anëtarët e udhëheqësisë së garës veprojnë secili në kuadër të kompetencave të veta, kurse për rastet që nuk janë paraparë me dispozitat e kësaj Rregulloreje ose me propozicionet, vendosin së bashku.

### **b) Delegati i Federatës**

#### **Neni 45.**

Obligimet e delegatit të lidhjes janë:

- Që para fillimit të garës të vërtetojë a janë plotësuar të gjitha kushtet teknike për mbajtjen e garës (arena, ndriçimi, përgatitjet etj.) dhe a i përgjigjet pajisja e pingpongut kushteve nga kjo Rregullore apo propozicioneve;
- Që të vërtetojë shërbimin e gjyqtarëve;
- Që të vërtetojë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë;
- Që të njoftohet me personat zyrtarë për udhëheqjen e garës;
- Që, para fillimit të garës, të shikojë rregullsinë e licencave për gara, duke përfshirë edhe kontrollimin mjekësor;
- Të kujdeset, që në ulësen në hapësirën për ndeshje të gjenden vetëm sportistët dhe personat zyrtarë;
- Të evidencojë të gjitha rastet të cilat i nënshtrohen dënimeve mandatore;
- Që në gara, kur sportisti apo personi zyrtar i shkel rregullat, të bëjë paraqitjen për procedurë disiplinore;
- Që në gara, kur sportisti apo shikuesi i shkel rregullat në mënyrë të rëndë, siguron largimin e tij nga palestra;
- Të evidencojë rezultatet e arritura;
- Që pas përfundimit të garës të shkruaj deklaratën.

Në garat me numër më të madh të pjesëmarrësve, një pjesë të punës së delegatit mund ta marrin komisionet e formuara për këtë qëllim, të cilat veprojnë nën mbikëqyrjen e delegatit.

Raporti i delegatit duhet të përmbajë:

- Rezultatet komplete të garës;
- Datën dhe vendin e mbajtjes së garës dhe emrin e organizatorit;
- Emrat e gjyqtarit suprem dhe të gjyqtarëve pranë tavolinës;
- Vërejtjet se a janë përmbushur të gjitha obligimet e organizatorit në kuptimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, veçanërisht për përgatitjet dhe për kushtet e ndeshjes;
- Informatën mbi sjelljen jo të mirë eventuale të shikuesve;
- Emrat e sportistëve, funksionarëve dhe personave zyrtarë, të cilët për shkak të sjelljes së pahijshme, kanë marrë kartonin e verdhë apo të kuq;
- Vërejtjet e pjesëmarrësve të garës
- Vërejtjet e gjyqtarit suprem;
- Vërejtjet e tij për organizimin e garës dhe notën përshkruese.

Raporti i delegatit duhet të bëhet menjëherë pas përfundimit të garës dhe personalisht ose në afat prej 24 orësh ta dërgojë në adresë të organit që e ka deleguar.



## **c) Gjyqtari suprem**

### **Neni 46.**

Për çdo garë duhet të caktohet gjyqtari suprem, së paku i asaj kategorie sa është niveli i rangut të garës.

Në garat ekipore me sistem të ligës, nëse me dispozita nuk është caktuar ndryshe, detyrimet e gjyqtarit suprem i merr gjyqtari pranë tavolinës.

Me emrin dhe vendin e banimit të gjyqtarit suprem duhet të jenë të njoftuar të gjithë pjesëmarrësit e garës, gjegjësisht kapitenët e ekipve.

### **Neni 47.**

Gjyqtari suprem është përgjegjës për:

- Hedhjen e shortit;
- Orarin e garës dhe të ndeshjes nëpër tavolina;
- Caktimin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve ndihmës;
- Vendosjen për të gjitha çështjet e interpretimit të rregullave, duke përfshirë edhe rregullësinë e veshmbathjes së sportistëve dhe pajisjes;
- Vendosjen, kur sportistët mund të bartin tuta (trenerka) gjatë ndeshjes;
- Vendosjen, kur mund të ndërpritet loja në rast nevoje;
- Vendosjen, kur sportistët mund ta lëshojnë hapësirën për ndeshje derisa zgjat loja;
- Vendosjen, kur mund të zgjatet koha e nxehtë;
- Marrjen e masave për shkak të sjelljes jo të mirë të sportistëve, gjyqtarëve dhe shkelësve të tjerë të rregullave.

Kur e sheh të arsyeshme gjyqtari suprem mund ta ndërrojë gjyqtarin, gjyqtarin ndihmës apo numëruesin e goditjeve.

Përgjegjësia e gjyqtarit suprem nga paragrafet 1-3 të këtij neni mund të bartet në persona tjerë ose në komisione.

Nëse përgjegjësia e gjyqtarit suprem bartet në persona tjerë ose në komisione, të gjithë pjesëmarrësit e garës duhet të njoftohen për vendin e banimit të atyre personave apo komisioneve.

### **Neni 48.**

Gjyqtari suprem mund të ketë zëvendësin.

Gjyqtari suprem ose zëvendësi i tij duhet të jenë të pranishëm në palestër gjatë tërë kohës së zhvillimit të garës.

## **d) Gjyqtari**

### **Neni 49.**

Për çdo ndeshje ekipore ose ndeshje individuale duhet të caktohet gjyqtari, i kategorisë që i përgjigjet nivelit të garave.

Për ndeshjet e ligës I kombëtare në konkurrencën e të rriturve dhe të rinjve drejtësinë e ndajnë dy gjyqtarë (kryesori dhe ndihmësi). Gjyqtari kryesor njëherit është edhe delegat i FPPK-së.

Ndeshjet e ligës II dhe të gjitha garat në konkurrencën e të rriturve dhe të rinjve i drejton një gjyqtar, i cili njëherit është edhe delegat i FPPK-së.

Ndeshjet e nivelit komunal dhe ndërkomunal, sikur edhe kategoritë e grup-moshave të reja mund t'i drejtojnë edhe personat, që nuk e kanë licencën e gjyqtarit, që me pajtimin e organizatorit e cakton gjyqtari suprem.

Pjesëmarrësit në garë nuk mund ta luajnë rolin e gjyqtarit në atë garë.

### **Neni 50.**

Gjyqtari drejton ndeshjen në pajtim me rregullat e pingpongut (Handbook, kreu 2), dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe është përgjegjës për atë çka ndodh brenda hapësirës për ndeshje.

Në kompetencat e drejtpërdrejta të gjyqtarit hyjnë:

- Vërtetimi i pranueshmërisë së kushteve për ndeshje dhe përgatitjeve dhe informimi i gjyqtarit suprem për parregullsitë eventuale;
- Zgjedhja e shërbimit dhe topit (nëse zgjedhja e topit nuk bëhet në ndonjë vend tjetër);
- Kontrollimi i radhitjes së shërbimit, ndërrimit të anëve dhe përmirësimit të gabimeve eventuale;
- Vendosja për çdo pikë, përveç kur gjyqtari ndihmës e ka të drejtën e vendosjes;

- Mbajtja e kontinuitetit të ndeshjes;
- Caktimi i zbatimit të mënyrës ekspeditive të ndeshjes;
- Lajmërimi i rezultatit;
- Zbatimi i rregullave për dhënien e udhëzimeve sportistëve;
- Zbatimi i rregullave për sjelljen e sportistëve.

## **Gjyqtari ndihmës**

### **Neni 51.**

Për çdo ndeshje ose meç individual mund të caktohet gjyqtari ndihmës.

Nëse është caktuar gjyqtari ndihmës, ai do të vendoset përballë gjyqtarit në vijë të rretës dhe mund:

- Të kontrollojë kohën e nxehjes, kohëzgjatjen e setit dhe kohëzgjatjen e pushimit;
- Të vendosë se a ka qenë shërbimi i sportistit i rregullt;
- Të vendosë në anën e tij të tavolinës a e ka prekur topi pjesën anësore të tavolinës, tehun e sipërfaqes për ndeshje ose që topi nuk ka prekur;
- Të vendosë a e ka prekur topi rretën gjatë shërbimit;
- Të numërojë goditjet e pranuesit të shërbimit gjatë zbatimit të mënyrës ekspeditive të ndeshjes (nëse për këtë nuk është caktuar ndonjë person tjetër);
- Të ndërpresë ndeshjen nëse janë shkelur kushtet për ndeshje në mënyrë që do të mund të ndikonin në rezultatin e ndeshjes.
- Vendimet e gjyqtarit ndihmës janë të plotëfuqishme kur kanë të bëjnë me faktet për të cilat është caktuar.

## **e) Personat zyrtarë**

### **Neni 52.**

Personat zyrtarë në gara (delegati dhe gjyqtarët) kanë të drejtë në taksë, së paku në shumë të cilën për çdo stinor garues e cakton Bordi i FPPK-së.

Nëse personi zyrtar e kryen detyrën e tij jashtë vendit të tij të banimit të përhershëm i takon kompensimi për hargjime të udhëtimit dhe mëditja sipas rregullave të FPPK-së.

### **Neni 53.**

Personat zyrtarë gjatë garës mund të bartin porosi propagandistike në mëngë me madhësi deri 40 cm<sup>2</sup>.

### **Neni 54.**

Për mos përmbushjen e detyrimeve të tyre personat zyrtarë i nënshtrohen procedurës disiplinore.

Gabimet disiplinore të personave zyrtarë i zgjedhin komisionet disiplinore të Federatës..

## **XIX. Rrjedha e garave**

### **Neni 55.**

Afër arenës, në vende të caktuar për këtë (ulëse), përveç sportistëve që luajnë, mund të qëndrojnë edhe më së shumti tre persona (trajneri, mjeku dhe udhëheqësi i rrugës).

## **a) Zgjedhja e topit**

### **Neni 56.**

Para fillimit të ndeshjes ekipore kapitenët e të dy ekipeve, te ndeshjet individuale sportistët pjesëmarrës, do ta zgjedhin topin me të cilin do të luhet (porositet të zgjedhen dy topa).

Nëse kapitenët apo sportistët nuk mund të pajtohen ose as që janë përpjekur për të zgjedhur topin, atë do ta bëjë gjyqtari.

Topi i zgjedhur njëherë nuk mund të ndërrohet përveç kur bëhet i papërdorshëm (pëlcet).

## **b) Nxehja**

### **Neni 57.**

Para fillimit të ndeshjes, sportistët kanë të drejtë të nxehen në tavolinën, në të cilën do të luhet, më së shumti deri në dy minuta.

Menjëherë pas përfundimit të nxehjes, sportistët duhet ta fillojnë ndeshjen. Kjo nënkupton që sportistët duhet të hyjnë në arenë me veshmbathje sportive dhe nuk lejohet dhënia e këshillave pas nxehjes, para fillimit të takimit.

Përrjashtimisht, nxehje të gjatë mund të lejojë gjyqtari suprem.

#### **Neni 58.**

Gjatë kohës së ndërprerjes ndërmjet setave dhe ndërprerjeve tjera të lejuara të ndeshjes sportistët nuk mund të stërvisin në tavolinën në të cilën do të luhet. Gjatë kohës së ndërprerjes për shkak të lëndimit gjyqtari suprem mund të lejojë stërvitjen në cilëndo tavolinë, duke përfshirë edhe tavolinën në të cilën luhet.

#### **c) Kontinuiteti ndeshjes**

#### **Neni 59.**

Ekipeve, gjegjësisht sportistët në garat individuale, janë të obliguar të paraqiten sipas orarit të paraparë menjëherë pasi të jenë thirrur.

Nëse ekipi ose sportisti nuk paraqitet edhe pasi të kenë kaluar pesë (5) minuta, do ta humbë takimin pa luftë.

Në garat ekipore, sipas sistemit të ligës, koha e pritjes së ekipeve është 30 minuta.

Në garat ekipore nuk lejohet shtyerja e takimeve, klubeve ju lejohet që të merren vesh për zhvillimin e ndeshjes më herët sesa që është e caktuar në orar. Përrjashtim nga ky rregull bëhet kur paraqiten kushte të jashtëzakonshme që pamundsojnë zhvillimin e rregullt të garës ekipore, në këto raste klubet dakordohen që të zhvillojnë ndeshja brenda 7 ditësh, respektivisht një ditë para garës së ardhshme ekipore, duke njoftuar komisionin e garave.

Te rastet e ndryshimit të orarit të ndryshimit të garave nga klubet, barra e mbulimit të shpenzimeve për gjyqtarin mbetet tek klubi që ka kërkuar ndryshimin, përveç nëse klubet pajtohen ndryshe.

#### **Neni 60.**

Gjyqtari është i detyruar të sigurojë që loja të zhvillohet në vazhdimësi përveç ndërprerjeve të lejuara. Gjatë kohës kur luhet seti gjyqtari, do të lejojë vetëm ndërprerje të shkurtëra për fshirje pas çdo gjashtë pikëve të zhvilluara dhe pas ndërrimit të anëve në setin vendimtar.

Për t'u shkurtuar ndërprerjet, peshqirët duhet të jenë në hapësirën për ndeshje.

Gjyqtari nuk do të lejojë pushime për shkak të bisedimit ose zhagjitjes dhe menjëherë kur njëri sportist apo njëri çift të jenë gati do ta ftojë edhe sportistin apo çiftin tjetër për ta vazhduar ndeshjen.

Sportistët do të mund të pushojnë nga një minutë pas çdo seti të luajtur.

#### **Neni 61.**

Raketa mund të ndërrohet vetëm nëse është thyer ose dëmtuar.

Nëse sportisti e ndërrohet raketën, ai këtë duhet ta bëjë sa më shpejt, kurse raketën e re duhet t'ia tregojë gjyqtarit dhe sportistit kundërshtar.

Me rastin e ndërrimit të raketës, gjyqtari do t'u lejojë sportistëve që me disa goditje provuese të njihen me raketën e re.

#### **Neni 62.**

Gjyqtari suprem mund të lejojë ndërprerjen e ndeshjes deri 10 minuta nëse sportisti përkohësisht është paaftësuar për ndeshje.

Ndërprerja nuk do të lejohet nëse paaftësimi për ndeshje ka ekzistuar ose është mundur të parashihet para fillimit të takimit, gjegjësisht nëse ka ardhur si rezultat i ngarkesës normale gjatë ndeshjes.

Paaftësimi i shkaktuar me shtangime ose rraskapitje do të konsiderohet si pasojë e ngarkesës normale të ndeshjes. Ndërprerja mund të lejohet vetëm kur paaftësimi ka ardhur si rezultat i lëndimit gjatë ndeshjes, p.sh. për shkak të rrëzuarjes etj.

#### **Neni 63.**

Ekipi ose sportisti kanë të drejtë në një minutë pushim (time out) gjatë një takimi.

Pushimin mund ta kërkojë sportisti ose këshilltari i tij.

Pushimi mund të kërkohet vetëm kur topi është jashtë ndeshjes dhe kërkohet me formimin e germës "T" me duar.

Dispozitat e këtij neni, do të zbatohen vetëm nëse ndeshjen e drejton gjyqtari i licencuar ose nëse është e caktuar posaçërisht në propozicione.

#### **Neni 64.**

Gjyqtari me thirrjen "stop" do ta ndërprejë ndeshjen nëse kushtet e ndeshjes janë thyer, p.sh me ikjen e korrentit elektrik, ndonjë zhurmë e papritur, me hyrjen e topit në arenë nga arena fqinje etj. Loja duhet të vazhdohet menjëherë pasi të tejkalohen kushtet për shkak të cilave është ndërprerë loja.

#### **d) Këshillat ndeshjendeshje**

Sportistët mund të marrin këshilla në çdo kohë, përveç gjatë zhvillimit të poenit, me kusht që ndeshja të mos vonohet me këshilla, nëse ndonjë person i autorizuar jep këshilla në mënyrë të paligjshme, arbitri do të mbajë një karton të verdhë për ta paralajmëruar se çdo shkelje e mëtejshme e tillë do të rezultojë në përjashtimin e tij ose të saj nga zona e ndeshjeve.

#### **Neni 65.**

Në garat ekipore sportistëve mund t'iu japë këshilla cilido person, i cili qëndron në vendin e caktuar për këtë (ulëse) afër arenës.

Në garat individuale sportistëve mund t'u japë këshilla vetëm personi i caktuar para takimit, që i është lajmëruar gjyqtarit.

#### **Neni 66.**

Nëse sportistit i jep këshilla personi që nuk është i caktuar me këtë Rregullore, do t'i jipet vërejtje me karton të verdhë, e nëse ai e përsërit këtë atëherë do të marrë kartonin e kuq dhe do të largohet nga palestra.

#### **Neni 67.**

Masat nga neni i mëparmë kanë të bëjnë vetëm me këshillat për mënyrën e udhëheqjes së ndeshjes dhe nuk e pengojnë sportistin apo kapitenin e ekipit që në çdo kohë të mund të bëjë ankesë kundër vendimit të gjyqtarit apo gjyqtarit ndihmës dhe të këshillohen për këtë.

#### **e) Sjelljet e sportistëve**

#### **Neni 68.**

Sportistët duhet të përmbahen nga sjelljet jo sportive, fyerjes së kundërshtarit, personave zyrtarë ose shikuesve, me çka do ta dëmtonin imazhin e tyre, imazhin e pingpongut ose materialisht do ta dëmtonin organizatorin.

#### **Neni 69.**

Sjellja jo sportive për të cilën gjyqtari mund t'i zbatojë masat, do të konsiderohet: dëmtimi i rekuizitave me qëllim (si p.sh. thyerja e topit, goditja me raketë në tavolinë etj.) bërtitja e tepërt, klithja, zhagitja e ndeshjes me qëllim, goditja me qëllim e topit jashtë hapësirës për ndeshjeje, mos respektimi i rregullave për marrjen e këshillave dhe mos respektimin e vendimeve të gjyqtarit.

Në rast të sjelljeve të tilla gjyqtari mund t'iu japë vërejtje sportistit duke i treguar kartonin e verdhë.

Nëse sportisti vazhdon të sillet në mënyrë jo sportive gjyqtari do t'iu tregojë edhe kartonin e kuq (së bashku) dhe do t'ia marrë pikën, e në rastin e përsëritur dy pikë dhe për sjelljen e tij të pahijshme do ta njoftojë gjyqtarin suprem.

#### **Neni 70.**

Në garat ekipore vërejtja (kartoni) e dhënë njëherë vlen për tërë ndeshjen (jo vetëm për atë meç vetjak), prandaj në rastin e përsëritur të sjelljes së pahijshme sportisti do të ndëshkohet me dënim më rigoroz.

Vërejtja ose dënimi i dhënë për shkak të sjelljes josportive të cilitdo sportist të çiftit do të konsiderohet, si gabim i çiftit, por jo edhe në sportistin që nuk e ka bërë gabimin.

#### **Neni 71.**

Në bazë të paraqitjes së gjyqtarit ose sipas gjykimit të tij, gjyqtari suprem mund të ndërmarrë masa ndaj sportistit, i cili sillet në mënyrë jo sportive. Në kuadër të masave disiplinore të zbatuara, sportisti mund të përjashtohet nga një pjesë ose nga tërë gara.

#### **Neni 72.**

Në garat ekipore deri në fitoren e katërt, sportisti i shkualifikuar mund të zëvendësohet nga sportisti rezervë në tri xhirot e ardhshme.

## **f) Leximi i rezultatit**

### **Neni 73.**

Gjyqtari është i obliguar që ta lexojë rezultatin posa topi të ketë pushuar së qeni në ndeshje, po sa të jetë e mundur, duke marrë parasysh duartrokitjet ose zërat tjerë, që do të mund të jenë më të zëshme se ai.

### **Neni 74.**

Me rastin e leximi të rezultatit, derisa zgjat seti, gjyqtari së pari e lexon numrin e pikëve të fituara të sportistit apo çiftit që duhet të shërbejë, e pastaj numrin e pikëve të fituara të kundërshtarit.

### **Neni 75.**

Në fillim të setit dhe pas ndërrimit të shërbyesit, gjyqtari e lexon rezultatin sipas radhitjes së caktuar, pastaj emrin e shërbyesit të ardhshëm.

### **Neni 76.**

Në fund të setit gjyqtari, së pari do të lexojë emrin e sportistit apo çiftit dhe numrin e pikëve që kanë fituar, e pastaj numrin e pikëve që i ka fituar kundërshtari.

### **Neni 77.**

Pas përfundimit të çdo takimi vetjak, në garat ekipore, gjyqtari do të lexojë gjendjen e tërësishme në ndeshjen ekipore.

### **Neni 78.**

Në garat me numër më të madh të pjesëmarrësve, organizatori është i obliguar që me kohë të lajmërojë rezultatet e takimeve të zhvilluara. Rezultatet lajmërohen përmes buletinit ose me shkruarjen e rezultateve në pano të posaçme të vendosura në palestër ose në paradhomë të palestrës.

## **X. Shpërblimet**

### **Neni 79.**

Në të gjitha garat zyrtare, ekipeve më të mira apo individëve më të mirë, organizatori u ndanë trofe sportivë ose mirënjohje.

Organizatori është i obliguar të sigurojë trofetë sportivë apo mirënjohjet, për së paku 3 (apo 4 nëse nuk luhet për vend të tretë) ekipet më të mira apo tre (apo 4 nëse nuk luhet për vend të tretë) sportistët më të mirë.

Në garat që organizohen nga federata, shpërblimet e trofeve i jep ajo ose lidhja e organizatorëve.

### **Neni 80.**

Kur është e caktuar me propozicione, organizatori, ekipeve apo sportistëve më të mirë mund t'iu ndajë edhe shpërblime tjera apo shpërblime në të holla.

## **XI. Dispozitat ndëshkuese**

### **Neni 81.**

Për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje për rastet e parashikuara me Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale, Komisioni disiplinor i FPPK-së në bazë të raportit të delegatit do të nisë procedurën disiplinore dhe të bjerë vendimin.

Për shkelje më të lehta të dispozitave të kësaj Rregulloreje, klubeve dhe sportistëve mund tu shqiptohet dënimi mandator:

### **Neni 82.**

**Vërejtje:** *Nenet 85-86 nuk do të aplikohen menjëherë për shkak të kushteve të vështira për momentin. Këto nene do të shqyrtohen nga Kuvendi në baza vjetore dhe Kuvendi do të marrë vendim të veçantë për hypjen në fuqi të tyre. Mbetet obligim i Organizatorëve që deri atëherë të sigurojnë kushte sa më të përafërta me këto nene.*

Klubi do ta paguajë dënimin mandator nëse:

Si nikoqir nuk e siguron hapësirën dhe pajisjet e parapara me këtë Rregullore;	€
Si nikoqir nuk e siguron shërbimin e gjyqtarëve;	€
Si nikoqir nuk siguron personel profesional të mjaftueshëm për rrjedhën e garës;	€
Si nikoqir nuk e ka siguruar dhënien e ndihmës së parë mjekësore;	€
Si nikoqir nuk e ka siguruar mundësinë e vendosjes dhe ushqimit të ekipeve dhe sportistëve udhëtues;	€
Si nikoqir nuk e ka varur flamurin e Kosovës;	€
Si nikoqir nuk e ka hartuar programin e garave;	€
Ekipi me pa të drejtë e lëshon garën derisa ende është në konkurrencë duke përfshirë edhe ndarjen e shpërblimeve;	50 €
Si nikoqir paraqitet (me lejen e delegatit) në fanella të njëjta sikur ekipi udhëtues	40 €
Sportistët e klubit si bashkësportistë në çifte nuk janë të veshur njësoj	10 €
Trajneri ose përfaqësuesi i klubit marrin karton të verdhë	30 €
Trajneri ose përfaqësuesi i klubit marrin karton të kuq dhe përjashtohen nga palestra	50 €
Nëse i shkel dispozitat e kësaj Rregulloreje të përshkruar në nenin 15. paragrafin 3.	10 €

### Neni 83.

Sportisti do të paguajë dënimin mandator nëse:

Me lejen e delegatit paraqitet në garë pa licencë për gara	€
E lëshon garën derisa ende është në konkurrencë duke përfshirë edhe ndarjen e shpërblimeve	10 €
E ngjet gomën në palestër apo në zhveshtore	10 €
Merr karton të verdhë për shkak të sjelljes jo sportive	5 €
Për shkak të sjelljes jo sportive merr kartonin e verdhë dhe të kuqin	10 €
Për shkak të sjelljes jo sportive, për herë të dytë, merr kartonin e verdhë dhe të kuqin	20 €

### Neni 84.

Dënimet mandatore i shqipton Komisioni i garave, në bazë të raportit të delegatit.

Llogaria për pagesën e dënimin mandator klubit ose sportistit, i dërgohet klubit dhe duhet të kryhet brenda 7 ditëve pas pranimit të tij.

Për shkak të mos pagesës së dënimin mandator të shqiptuar klubit, automatikisht klubi është i pezulluar, ndërsa për shkak të mos pagesës së dënimin mandator të shqiptuar sportistit, ky i fundit është i pezulluar automatikisht.

## XII. Ankesat

### Neni 85.

Kurrëfarë marrëveshje ndërmjet sportistëve nuk mund të vendosë për faktet e kompetencave të gjyqtarit ose gjyqtarit ndihmës, as për çështjet tjera të lidhura me garën ose udhëheqjen e garës nga kompetencat e udhëheqësisë së garave.

### Neni 86.

Nuk mund të bëhet ankesë kundër vendimit të gjyqtarit, që rrjedh nga kompetencat e tij ose të gjyqtarit ndihmës rreth interpretimit të rregullave dhe atëherë vendimtar do të jetë vendimi i gjyqtarit suprem.

### Neni 87.

Mund t'i bëhet ankesë gjyqtarit suprem kundër vendimit të gjyqtarit apo gjyqtarit ndihmës me rastin e interpretimit të rregullave dhe atëherë vendimtar do të jetë vendimi i gjyqtarit suprem.

#### **Neni 88.**

Mund t'i bëhet ankesë udhëheqësisë së garës kundër vendimit të gjyqtarit suprem lidhur me çështjet e garës ose udhëheqjes së garave, që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, atëherë vendimi i udhëheqësisë së garave do të jetë përfundimtar.

#### **Neni 89.**

Në garën individuale ankesë mund të bëjë vetëm sportisti, i cili ka marrë pjesë në ndeshje në të cilën ka ardhur deri te kontesti, kurse në garën ekipore vetëm kapiteni i ekipit që ka marrë pjesë në ndeshje.

#### **Neni 90.**

Kërkesën për interpretimin e kësaj rregulle, e cila ka dalur nga vendimi i udhëheqësisë së garës, ka të drejtë ta bëjë vetëm sportisti apo kapiteni i ekipit dhe atë nëpërmjet delegatit të lidhjes në atë garë.

### **XIII. Komisioni i garave**

#### **Neni 91.**

Të gjitha punët profesionalo-teknike lidhur me organizimin dhe mbajtjen e garave, duke e përfshirë edhe shqiptimin e dënimeve mandatore, në mënyrë të pavarur e bën Komisioni i garave. Mandati i kryetarit dhe Komisionit të garave zgjat aq sa zgjat edhe mandati i anëtarëve të Bordit, i cili i ka emëruar.

Komisioni vepron sipas Rregullores për punën e Komisionit të garave, të cilën e ka lejuar Bordi.

### **XIV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 92**

1. Komisioni i garave është autoriteti kompetent për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullore.
2. Të gjithë anëtarët e FPPK-së, sportistët dhe pjesëmarrësit e paraqitur për pjesëmarrje dhe të përfshirë në aktivitetet e Federatës, i nënshtrohen dispozitave të kësaj Rregulloreje.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja për organizimin e garave e vitit 2022.

#### **Neni 93**

1. Bordi i FPPK-së mund ti propozojë Kuvendit të FPPK-së që disa gara të organizohen ndryshe nga ajo që është e paraparë me këtë Rregullore.
2. Kuvendi ka të drejtën të bëjë ndryshimin e sistemit të garave dhe i njëjti bëhet pjesë e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 94** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn pas nënshkrimit nga Kryetari i FPPK-së dhe e njëjta publikohet në faqen zyrtare të Federatës.



**Nehat Çitaku**

**Kryetar**